



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Programi mësimor i lëndës (Syllabusi)		
Fakulteti:	Fakulteti Ekonomik	
Programi/Departamenti:	Biznes dhe Menaxhment. Specializimi: Banka, Financë dhe kontabilitet	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Financat Publike	
Statusi i lëndës:		Obligative
Semestri:		Dimëror
Fondi i orëve:	2+1	Sipas programit të aprovuar
ECTS:	6	Sipas programit të aprovuar
Orari/Salla	Salla 403 / Amfiteatër 2	
Viti akademik:	Viti i II, Semestri i III	
Mësimdhënës/e:	Prof. Asoc. Dr. Esat A. DURGUTI	
Asistent/e:	Besë SADIKAJ, PhD.C & Milaim MEHMETI, Msc.	
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
E-mail:	esat.durguti@umib.net	bese.sadikaj@umib.net milaim.mehmeti@umib.net
Telefon:	+ 383 (0) 44 152 975	

PERMB AJTJE	Financat publike janë pjesë përbërëse e ekonomikut që studiojnë funksionimin e qeverisë dhe mënyrat alternative të financimit të shpenzimeve të qeverisë. Ky modul përfshinë integrimin e zbatimit të politikave fiskale në financat publike, administrimin fiskal dhe menaxhimin e të ardhurave; me vëmendje të veçantë për taksimin dhe administrimin e të ardhurave, buxhetimin qeveritar, konsideratat teorike mbi hartimin e sistemit tatimor dhe përcaktimin e madhësisë së sektorit publik.
QËLLIM I	Qëllimi i lëndës financat publike është që në fund të semestrit studentët të kenë njohuri të qartë dhe aftësi të avancuara për të rezonuar lidhur me çështjet ekonomike që kanë të bëjnë me sektorin publik. Qëllimi gjithashtu, është edhe gërshetimi i të dhënave institucionale, teorike dhe ekonometrike që studentët të aftësohen për të vlerësuar në mënyrë parimore shpenzimet qeveritare dhe tatimet. Dhe synimi përfundimtar i këtij moduli është që në fund të semestrit studenti të jetë i sigurt dhe i aftë në shpjegimin dhe interpretimin ekonomik të problemeve të botës reale. Pas përfundimit të suksesshëm të modulit financat publike studentët do të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë kritike mekanizmin e funksionimit modern të financave publike.

ARRITS HMËRI A	❑ Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: 1. <u>Të përshkruajnë</u> procesin e funksionimit të financave publike moderne, 2. <u>Të identifikojnë</u> llojet e nevojave publike dhe mekanizmat e tyre të financimit, 3. <u>Të analizojnë</u> çështjet kritike në kuadër të financave publike, të informuara nga studimet e fundit empirike, 4. <u>Të argumentojnë</u> bazën teorike të hyrave & shpenzimeve publike, të analizojnë llojet e tyre si dhe efektet ekonomike, 5. <u>Të rekomandojnë</u> propozimet e tyre mbi klasifikimin e të ardhurave publike dhe integrimin e tyre në sistemin tatimor dhe fiskal, dhe 6. <u>Të krijojnë analiza</u> mbi të ardhurat dhe shpenzime publike përmes buxhetit si dhe të analizojnë instrumentet dhe objektivat e politikës buxhetore.	
PROGR AMI	Javët	Tema
	Java - I	Pasqyrë përmblledhëse e përmbajtjes së lëndës – Ligjëratë hyrëse (Syllabusi)
	Java - II	Vështrimi mbi financat publike
	Java - III	Baza ekonomike për aktivitetin e qeverisë
	Java - IV	Të dalat publike
	Java - V	Të hyrat publike
	Java - VI	Tatimet dhe parimet tatimore – analizë e legjislacionit tatimor të Kosovës – Guest Speaker nga Administrata Tatimore e Kosovës
	Java - VII	Efektet e tatimit
	Java - VIII	<i>Kollokviumi i Parë</i>
	Java - IX	Borxhi publik
	Java - X	Analizë rasti: Ndikimi shpenzimeve buxhetore, të hyrave buxhetore, borxhit publik dhe ndikimi i tyre në rritjen ekonomike - trajtimi i artikujve shkencore
	Java - XI	Korniza rregullative dhe aplikimi i financave publike në Kosovë
	Java - XII	Korniza rregullative dhe funksionimi i sistemit tatimor në Kosovë
	Java - XIII	Doganat
	Java - XIV	Buxheti i shtetit
	<u>Java - XV</u>	<i>Kollokviumi i Dytë (Provimi final)</i>

LITERATURA	Literatura themelore: 1. Komoni Sabahudin. (2018). Financat Publike – Prishtinë - 2018. 2. Gruber Johnathan (2012). Public Finance and Public Policy – A Macmillan Higher Education Company, 2012. 3. Rosen S. Harvey (2010). Financat Publike – Shtëpia Botuese UET Press- Tiranë, Shqipëria - "i përkthyer në Gjuhën Shqipe". Literatura plotësuese: 1. Durguti, Esat., Tmava, Qazim., Demiri-Kunoviku, Filloreta., & Krasniqi, Enver., (2021). Panel estimating effects of macroeconomic determinants on inflation: Evidence of Western Balkan, Cogent Economics & Finance, 9:1, 1942601, DOI: 10.1080/23322039.2021.1942601. 2. Gllogjani, L., & Balaj, D. (2021). The Assessment of Fiscal Deficit on Economic Growth in Transition Countries of South-Eastern Europe. Journal of Liberty and International Affairs, 7(3), 102-117. DOI: 10.47305/JLIA2137102g. 3. LIGJI NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË. 4. Prezantimi nga ligjërata do të shpërndahet tek studentët
METODOLOGJIA E MËSIM DHËNJËS	Metodologjia e përdorur në mësimdhënie dhe mësim nxënie do të jetë ajo e praktikave më të mira: ligjërata interaktive, diskutime, detyra kursi, projekte të pavarura, ushtrime, konsultime dhe punime kërkimore në grup. Mësimi do të zhvillohet përmes ligjëratave, detyrave praktike, interpretimeve individuale dhe grupore, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohen në aspektet teorike dhe praktike duke i paraqitur materialet në formë audio vizuale përmes kompjuterit, projektorit dhe në tabelë. Në kuadër të këtij semestri janë të paraparë 15 Javë me nga 2 orë ligjërata dhe 1 ushtrime (seminare dhe diskutime), si dhe dy kollokfiume të cilat mbahen brenda 15 ligjëratave të planifikuara (javën e 7 dhe 15). Studimet e rastit dhe detyrat e shtëpisë jepen pas çdo ligjërate për studentët me qëllim që studentët të studiojnë dhe hulumtojnë në kohën e studimeve vetanake. Rezultatet nga aktivitetet e tilla paraqiten dhe diskutohen në javën vijuese. Studentët inkurajohen për të ndjekur zhvillimet aktuale ekonomike duke lexuar artikuj, revistat ekonomike si dhe materiale të tjera relevante. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat e radhës për diskutim nga lexime të tilla. Esetë e përgatitura nga studentët gjithashtu do të diskutohen si dhe inkurajohen prezantimet individuale dhe grupore.

	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	2	15	30
	Ushtrime	1	15	15
	Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	2	15	30
	Kolokfiume /seminare	2	2	4
	Detyra të pavarura			
	Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
	Përgatitja përfundimtare për provim	5	4	20
	Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	/	/	/
	Projektet, prezantimet, etj	1	8	8
	Totali			152 orë= 6.08 ECTS
VLERËS IMI	Metodat e vlerësimit: Vlerësimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive do të bëhet sipas kësaj kronologjie: 1. Pjesëmarrja dhe interaktiviteti gjatë leksioneve 10%, 2. Punime dhe projekte kërkimore në grup 10%, 3. Testi i parë i vlerësimit 30% dhe 4. Testi i dytë i vlerësimit 30%, dhe 5. Kuize në klasë 10%. 6. Gjithsej 100% e pikëve. (Studentët të cilët nuk kanë kaluar provimin, ose janë të pa kënaqur me notën mund ti nënshtrohen komplet provimit, ose pjesët të cilët nuk kanë pikë të mjaftueshme) Shkallët e notave: ▪ 50-me pak – nota 5 (pesë) ▪ 51-60 % - nota 6 (gjashtë) ▪ 61-70 % - nota 7 (shtatë) ▪ 71-80 % - nota 8 (tetë) ▪ 81-90 % - nota (nëntë) ▪ 91-100 % - nota (dhjetë)			
POLITI KAT AKADE MIKE	Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata. Ata pritet gjithashtu të jenë aktiv në ligjërata, seminare dhe diskutimeve individuale dhe grupore. Profesori është në dispozicion për konsultime individuale. Studentët janë të detyruar për të lexuar literaturë para çdo ligjërate. Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera të universitetit. Kodi i mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.			

Mitrovicë

10/10/2021

Bartës/e i/e lëndës:

Prof. Ass. Dr. Esat A. DURGUTI

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)